

PËRDORIMI I TIK-UT NË NJEF DHE NGA INDIVIDË (ISOC_I)

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
5.1 Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	5
8. Politika e botimit	6
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Menaxhimi i cilësisë	7
12. Rëndësia	8
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	9
15. Kohërendja dhe Krahueshmëria.....	10
16. Kostoja dhe ngarkesa	10
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	10
17. Rishikimi i të dhënave.....	10
18. Përpunimi statistikor	11
19. Komente	12
Aneks	12

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Spektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve dhe TIK, Drejtoria e Popullsisë dhe Statistikave Sociale
1.3. Personi i kontaktit	Eriona Dhamo
1.4. Funkcioni i personit të kontaktit	Përgjegjës, Spektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve dhe TIK
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	edhamo@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	11.12.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	11.12.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	11.12.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Të dhënat për këtë fushë mblidhen çdo vit nga INSTAT dhe bazohen në pyetësorët model vjetor të Eurostat për Përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në NjEF dhe Individë (TIK). Anketa ka një pyetësor model (PM) i cili ndryshohet çdo vit. Ndryshimet e pyetjeve në PM kërkohen nga situata evoluese dhe dinamike e fushës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit. Qëllimi i vrojtimeve Evropiane për TIK është sigurimi në kohë i statistikave të krahasueshme për individët dhe NjEF për përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit në nivelin Evropian. Të dhënat për këtë aktivitet statistikor sigurohen nëpërmjet vrojtimeve. Të dhënat të cilat mblidhen mundësojnë prodhimin e statistikave sipas seksioneve të mëposhtme:

	• Qasja dhe përdorimi i TIK-ve nga individë dhe / ose në NjEF; • Përdorimi i internetit dhe teknologjive të tjera për qëllime të ndryshme nga individë dhe / ose në NjEF; • Siguria dhe besimi i TIK-ut; • Njohuritë dhe aftësitë e TIK-ut; • Vështirësitë në përdorimin e TIK-ut dhe internetit; • Efektet e perceptuara të përdorimit të TIK-ut tek individët dhe / ose NjEF; • Përdorimi i TIK-ut nga individët për të komunikuar, shkëmbyer të dhëna dhe përfituar shërbime nga qeveria dhe institucionet e administratës publike (e-qeverisja); • Hyrja dhe përdorimi i teknologjive që mundësojnë lidhje me internetin ose rrjetet e tjera nga kudo në çdo kohë (lidhje e gjithëpranishme).
3.2. Sistemi i klasifikimit	TIK në NjEF mbledh informacione edhe mbi karakteristikat socio-demografike. Klasifikimet Ndërkombëtare të përdorura në këtë studim janë: 1. Lista Kombëtare e Profesioneve (e miratuar sipas Klasifikimit Standard Ndërkombëtar të Profesioneve - ISCO 08). 2. Sistemi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit (ISCED 2011).
3.3. Mbulimi i sektorit	Vrojtimi është një studim i përgjithshëm i popullsisë / NjEF.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Vrojtimi pranë NjEF përfshin pyetje në nivel NjEF dhe individ. Të dhënat në nivel NjEF dhe individ janë të ndara siç përshkruhet në pikën 3.1. Eurostat siguron një pyetësor model për përdorimin e TIK-ut në NjEF / nga individë i cili mbulon fushat e mëposhtme: • Aksesit në Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (të dhënat e mbledhura në nivel NjEF); • Përdorimi i internetit (të dhënat e mbledhura në nivel individual); • Përdorimi i kompjuterave, vendndodhja, shpeshtësia e përdorimit, aktivitetet (të dhënat e mbledhura në nivel individual); • Përdorimi i e-Qeverisë (të dhënat e mbledhura në nivel individual); • Përdorimi i e-Blerjeve (të dhënat e mbledhura në nivel individual); • Aftësitë teknologjike/kompjuterike; • Siguria në internet; • Karakteristikat socio-demografike. Përkufizimet: Një njësi ekonomike familjare (NjEF) i referohet një grupi personash ose një personi me lidhje gjaku ose jo të cilët banojnë së bashku në një banesë dhe që ndajnë një ekonomi pjesërisht ose plotësisht të përbashkët. Periudha e referencës/referuese është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar. Interneti është sistemi i rrjeteve kompjuterike të ndërlidhura që përdor Suitën e

	Protokollit të Internetit (TCP/IP) për të lidhur miliarda pajisje në të gjithë botën. Ai është një rrjet i rrjeteve që përbëhet nga miliona rrjete private, publike, akademike, biznese dhe qeveritare, me fushëveprim lokal deri në global, të lidhura nga një koleksion i gjerë elektronik, wireless dhe teknologjitë e rrjeteve optike. Interneti mbart një gamë të gjerë të burimeve të informacionit dhe shërbimeve, të tilla si dokumentet e ndërlidhura hypertext dhe aplikacionet e World Wide Web (WWW), posta elektronike, telefonja dhe rrjetet peer-to-peer për file sharing. Akses i referohet qasjes në internet jo vetëm në shtëpi por edhe nëse anëtarët e NjEF mund t'a aksesojnë atë kur / ku të duan. Shërbimi me Internet Broadband është forma më e përdorur e qasjes në internet për shkak të shpejtësisë së lartë; ajo ofrohet në disa forma të ndryshme, DSL, ADSL gjithashtu fibra optike, kabllor dhe satelit, rrjete WiFi publike, përmes antenës. Për detaje në të gjitha përkufizimet shihni metodologjinë.
3.5. Njësia statistikore	NjEF dhe individët.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore janë të gjitha NjEF me vendbanim të zakonshëm në Shqipëri. Kampioni i vrojtimit mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë.
3.7. Zona e referencës	Anketa mbi përdorimin e TIK në NjEF dhe nga Individët mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë. Banesat kolektive, shtëpitë për të moshuarit, spitalet, shtëpitë e rehabilitimit, duke përfshirë spitalet për fëmijë, shkollat me konvikte, hotelet, sanatorimet, institucione korrektuese dhe penale nuk janë të përfshira në vrojtimit.
3.8. Mbulimi në kohë	Anketa mbi përdorimin e TIK në NjEF dhe nga Individët ka një shtrirje kohore 2 mujore çdo vit. Të dhënat janë mbledhur për herë të parë në vitin 2018, duke krijuar një seri kohore deri në vitin 2025 prej 8 vitesh.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Përqindja përdoret si njësi e matjes për treguesit kryesorë të publikimit.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Periodiciteti është vjetor, të dhënat mblidhen dhe përpilohen një herë në vit. Ky raport i përket vitit referencë 2025.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore mbi të cilën bazohet studimi vjetor i TIK-ut në NjEF konsiston në:

	• Ligji Nr.17 / 2018, "Për Statistikat Zyrtare"; • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Rezultatet e vrojtimit mbi përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët, në mënyrë që të krahasohen me vendet Evropiane, prodhohen duke zbatuar rregulloret e reja të Komisionit Evropian (KE); • Rregullore (EU) 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat mbi përdorimin e TIK në NjEF dhe Individët transmetohen në Eurostat.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligj Nr. 124/2024 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhëna që ka marrë ose ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin direkt ose indirekt të njësive statistikore. Instituti i Statistikave në Shqipëri merr të gjitha masat e duhura parandaluese në mënyrë që të bëjë të pamundur identifikimin e njësive individuale statistikore me mjete teknike ose mjete të tjera që mund të përdoren në mënyrë të arsyeshme nga një palë e tretë. Të dhënat statistikore që mund të mundësojnë identifikimin e njësisë statistikore shpërndahen nga Instituti i Statistikave në Shqipëri nëse dhe vetëm nëse: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç përcaktohet në mënyrë specifike në Rregullore, në atë mënyrë që shpërndarja e tyre të mos çënojë konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë pëlqimin e saj, pa asnjë rezervë, për zbulimin e të dhënave. Të dhënat konfidenciale që i transmetohen Institutit të Statistikave në Shqipëri përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe të vetmit persona që kanë të drejtë të kenë akses në këto të dhëna janë personeli i angazhuar në këtë detyrë. Çështjet që i referohen respektimit të konfidencialitetit statistikor shqyrtohen nga stafi që punon në Institutin e Statistikave në Shqipëri. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë: në cilin nivel të detajuar mund të shpërndahen të dhënat

	statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejt ose indirekt, i njësisë statistikore të anketuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për studiuesit për të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet për shpërndarjen e statistikave publikohen në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe vonesat janë para-shpallur në këtë kalendar. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses i kalendarin e publikimeve	Kalendari i Publikimeve është në dispozicion në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë një të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe të përdoren të gjitha format e mundshme të mediave. INSTAT dhe agjensitë statistikore, që kanë në program përgjegjësitë e shpërndarjes, kërkojnë të plotësojnë çdo kërkesë të ndonjë organizate ose individit për të dhëna të pabotuara ose analiza specifike. Kanalet e mëposhtme të shpërndarjes përdoren për të nxjerrë rezultatet e Përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga individë: 1. Njoftimi për shtyp; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Të dhënat në formë tabele; 4. Të dhëna në databazën statistikore; 5. Seksioni kërkesa të dhënash për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	
9.1 Shpeshtësia e shpërndarjes	Rezultatet e Anketës mbi Përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët publikohen çdo vit.
10. Akses i të dhënave dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacione mbi treguesit kryesorë të siguruar nga vrojtimi. Format i njoftimit për shtyp përcaktohet nga sektori i publikimeve, i cili vendos dhe datën e publikimit në kalendarin zyrtar të publikimeve. Njoftimi për shtyp të përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga individë publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet e përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga individë janë botuar në faqen e internetit të INSTAT: Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në NjEF, 2025 .
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet janë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe angleze. Të dhënat për përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individë mund ti aksesoni në bazën

	e të dhënave statistikore. • Lloji i aksesit të lidhjes së internetit të NjEF; • Pajisjet kryesore të përdorura për të aksesuar internetin (gjatë 3 muajve të fundit) sipas gjinisë dhe grupmoshave; • Shpërndarja e individëve në përdorimin e TIK sipas grup moshave për blerjet online; • Shpërndarja e individëve që ndërveprojnë me autoritetet publike (e-geverisjes) gjatë 12 muajve të fundit; • Shpërndarja e NjEF-ve që kanë akses në internet.
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Baza e të dhënave në nivel mikro nuk publikohet për arsye konfidencialiteti. Të dhënat e grumbulluara janë lloji i vetëm i të dhënave që u jepet përdoruesve të jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk janë publikuar, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të paraqesin kërkesa specifike për të dhënat e vrojtimit mbi "Përdorimi i TIK-ut në NjEF dhe nga individë" përmes një pjese të veçantë: Kërkesë të dhënash.
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër në lidhje me përkufizimet e koncepteve kryesore dhe shpjegimeve metodologjike u jepet përdoruesve në fund të njoftimeve për shtyp dhe publikimeve. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme ose kur kërkohet. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi vrojtimin.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Spektori i Statistikave të Konsumit të Familjeve dhe TIK dokumenton të gjithë procesin dhe procedurën e punës për përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e informacionit statistikor. Në përputhje me Ligjin e Statistikave, INSTAT përdor metoda statistikore dhe procese në përputhje me parimet shkencore dhe standardet e njohura ndërkombëtarisht, bëjnë analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim të përmirësimit të cilësisë dhe të sigurojnë që statistikatat janë më të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, ai ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Praktikave së Statistikave Evropiane . INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve, orientimi i përdoruesit, orientimi i punonjësve, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e anketës së përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga Individët të krahasohen me të dhënat e vitit të kaluar për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.

12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e anketës së përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga Individët klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm. Përdoruesit e jashtëm janë: • Institucionet e administratës publike; • Universitetet; • OJF kombëtare dhe ndërkombëtare; • Firma private; • Studiues, studentë dhe grupe të tjera të ngjashme. Me përdoruesit e brendshëm, nënkupton sektorë të tjerë brenda INSTAT që përdorin të dhënat e anketës si input në punën e tyre. Publikimet e rezultateve të përdorimit të TIK-ut në Familje NjEF dhe nga Individët publikohen çdo vit. Një pjesë e treguesve kryesorë transmetohet gjithashtu përmes plotësimit të pyetësorëve standardë të kërkuar nga organizata ndërkombëtare, përfshirë Komisionin Evropian, Eurostat dhe International Telecommunication Union (ITU).
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e temës "Teknologjia e informacionit dhe Komunikimit" u vlerësua 3.82 (76.4%) në një shkallë 1 (shumë e dobët) në 5 (shumë e mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave të TIK-ut në NjEF dhe nga Individët gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar nga INSTAT me ato të rregulloreve të ndjekura. Përdorimet e TIK-ut në NjEF dhe statistikat e individëve, në mënyrë që të jenë të krahasueshme me ato të vendeve evropiane, prodhohen duke zbatuar rregulloren e re të Komisionit Evropian Rregullore (EU) 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit. Shkalla e plotshmërisë të të dhënave për anketën mbi përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët për vitin 2025 është 100%. Kjo llogaritje bazohet duke marrë parasysh raportin e kërkesave të përmbushura nga INSTAT me atë që kërkohet nga rregulloret evropiane.
13. Saktësia dhe besueshmëria	
13.1. Saktësia e përgjithshme	Në përgjithësi, të dhënat kontrollohen me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në ecurinë e të dhënave. Kur ndodhin ndryshime, të dhënat e anketës kontrollohen me burime alternative, nëse ka. Kur nuk ka informacion nga burime alternative, INSTAT korrigjon ose konfirmon të dhënat duke përdorur email ose duke telefonuar personat që i janë përgjigjur anketës. Masat e marra nga INSTAT çdo vit, për të rritur shkallët e përgjigjes ose për të zvogëluar ndikimin e mos përgjigjeve duke i imputuar ato janë si më poshtë:

	Të dhënat grumbullohen direkt në NjEF dhe individ;						
13.2. Gabim i kampionimit	Anketa e përdorimit të TIK në NjEF dhe nga Individë 2025 u krye nga INSTAT përgjatë dy muajve të vitit, me një kampion prej 7.200 NjEF. Në përfundim të vrojtimit ishin intervistuar 5.413 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 75,2%. Gabimi për shkak të marrjes së mostrës së probabilitetit vlerësohet për tregues më të rëndësishëm, të cilat mund t'i gjeni në Tabelën A1 në Aneks. Të gjitha vlerat e treguesve peshohen për të qenë përfaqësuese për të gjithë popullsinë.						
13.3. Gabim jo i kampionimit	Mos-përgjigja në nivel njësie merr në konsideratë NjEF që nuk janë në gjendje ose të gatshme për t'u përgjigjur, ose kur intervistuesit nuk janë në gjendje të gjejnë NjEF, ose kur ekzistojnë pengesa të tjera për të mos kryer intervistën. Niveli i mos-përgjigjes së njërive për “Përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët për vitin 2025 është 24,8%. Shkalla e mos-përgjigjes në nivel variabli për “Përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët për vitin 2025 është 0%. Zakonisht, kur NjEF pranojnë t'i përgjigjen anketës, ata përgjigjen në të gjitha pyetjet e anketës. Mbi-mbulimi tregon përqindjen e NjEF që nuk duhet të jenë pjesë e vrojtimit, pasi ato janë jashtë fushës së studimit. Shkalla e mbi-mbulimit për “Përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët për vitin 2025 është 5,9%.						
14. Afatet kohore dhe përpikmëria							
14.1. Afatet kohore	Rezultatet e përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga individë janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 161 ditë pas përfundimit të grumbullimit të të dhënave (T+161). Periudha referuese është kohëzgjatja së cilës i referohet një çështje e caktuar informacioni. Anketa përdor periudha të ndryshme reference në varësi të tipit të informacionit që duhet marrë dhe objektivave të secilës çështje për t'u analizuar. Në vitin 2025 anketa është kryer në periudhën Maj – Korrik 2025. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>7/3/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>12/11/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>161</td></tr> </table>	Periudha referuese	7/3/2025	Data e publikimit	12/11/2025	Afatet kohore	161
Periudha referuese	7/3/2025						
Data e publikimit	12/11/2025						
Afatet kohore	161						
14.2. Përpikmëria	Të dhënat e Anketës së TIK shpërndahen sipas afatit të ri për publikim. Publikimi i përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga individë ka qenë i përpiktë në kohë në 100% të publikimeve të kryera ndër vite. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>7/3/2025</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>12/11/2025</td></tr> </table>	Periudha referuese	7/3/2025	Data e shpallur	12/11/2025		
Periudha referuese	7/3/2025						
Data e shpallur	12/11/2025						

	Data e publikimit	12/11/2025	
	Vonesa në kohë	0	
15. Koherenca dhe Krahaseshmëria			
15.1. Krahaseshmëria gjeografike	Të dhënat për përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët mblidhen sipas Rregullores (KE) Nr. 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Shoqërinë e Informacionit, si dhe rregulloret vjetore të zbatimit që përcaktojnë variablat e monitoruara çdo vit. Meqënëse pyetësi i përdorur është i njëjtë siç kërkohet nga Rregulloret e Eurostat, statistikën mbi përdorimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në NjEF dhe nga Individët mund të jenë të krahasueshme me ato të vendeve anëtare. Të dhënat janë gjithëpërfshirëse dhe prodhohen në nivelin vendi.		
15.2. Krahaseshmëria kohore	Të dhënat mbi përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët u prodhuan për herë të parë në 2018. Ato janë të krahasueshme ndër vite për pjesën më të madhe të indikatorëve, duke na siguruar një krahasueshmëri të mirë prej 8 vitesh, (CC2 = Jlast - Jfirst + 1 = 8). Krahaseshmëri të ulët vit pas viti për ato variabla/indikatorë që kanë ndryshuar si pasojë e ndryshimit të përkufizimeve dhe/ose pyetjeve në pyetësorë si pasojë e nevojës së matjes së zhvillimeve në TIK (p.sh internet nga telefoni, aftësitë).		
15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet. Nuk ka asnjë studim apo burim të krahasueshëm administrativ që mund të merret si referencë për TIK-un në NjEF dhe nga Individët. Vetëm të dhënat përfundimtare në përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët janë publikuar.		
15.4. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohen para se të finalizohet. Lidhja midis variablave kontrollohet dhe koherenca ndërmjet serive të ndryshme të të dhënave kontrollohen para publikimit.		
16. Kostoja dhe ngarkesa			
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Personeli që punon për anketën e përdorimit të TIK-ut në NjEF dhe nga Individët janë: • Stafi i përgjithshëm në Zyrat Qendrore: 4 punonjës; • Stafi në Zyrat Rajonale: 28 punonjës; • Anketues, Kontrollorë (Staf i përkohshëm i INSTAT): 52 anketues.		
17. Rishikimi i të dhënave			
17.1. Politika e rishikimit	Politika e rishikimit përdorimi i TIK-ut në NjEF dhe nga Individët bëhet në përputhje me politikën e rishikimit të përgjithshëm dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantuar nga INSTAT i cili mund të gjendet:		

	• Politika e Revizionimit Statistikor; • Politika e Trajtimit të Gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Nuk janë kryer rishikime të të dhënave mbi "Përdorimin e TIK-ut në NjEF dhe nga Individët" për vitin 2025, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Në vitin 2025, Anketa mbi Përdorimin e TIK në NjEF dhe nga Individët u krye me një kampion prej 7.200 NjEF. Në përfundim të vrojtimit u intervistuan 5.413 NjEF të shpërndara në mënyrë uniforme në të gjithë territorin e Shqipërisë. Shkalla e përgjigjes së NjEF, e llogaritur si raport i numrit të NjEF që kanë plotësuar anketën ndaj numrit të NjEF të zgjedhura, shprehur në përqindje rezultoi 75,2%. Zgjedhja e kampionit bëhet sipas një procedure dy-hapëshe. Njësitë e hapit të parë (PSU) janë zonat e Censit të Popullsisë dhe Banesave të homogjenizuara, me probabilitet përpjesëtimor me madhësinë e zonës së Censit. Në hapin e dytë, brenda secilës prej zonave të zgjedhura në hapin e parë, zgjidhen sipas metodës së zgjedhjes sistematike me probabilitet të barabartë një numër fiks prej 10 NjEF. Zgjedhja në të dyja hapat është bërë në mënyrë të rastësore.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen çdo vit.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat grumbullohen duke përdorur metodën CAPI, me intervista ballë për ballë duke përdorur pyetësorë në laptop. NjEF ose individët duhet të identifikohen për t'u intervistuar, kampioni ndahet midis anketuesve; anketuesit përzgjidhen dhe trajnohen.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Për sa i përket vlefshmërisë së të dhënave, procedurat e redaktimit të të dhënave përgjithësisht i referohen nivelit mikro: 1. Kontrolli sasior dhe cilësor i pyetësorit. • Kontrolli i pyetësorëve në hyrje, kontrollet e plotshmërisë, kontrolli logjik i pyetësorit. Numri i pyetësorëve që vijnë duhet të jetë i barabartë me numrin e pyetësorëve të shpërndarë në qarqe. • Kontrollet individuale bëhen për rastet e refuzimit dhe pa kontakte. 2. Korrigjimet aritmetike, korrigjimet logjike dhe verifikimi i koherencës midis përgjigjeve në pyetje të ndryshme të pyetësorit i cili kryhet me software-in SPSS.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Për përpilimin e rezultateve kemi tre procedura bazë: 1. Analiza e cilësisë së të dhënave Për të analizuar cilësinë e të dhënave janë aplikuar disa rregulla:

	• Kontrolli matematik i anketës; • Kontrolli logjik i të dhënave të anketës; • Krahاسimi i të dhënave në seri kohore; • Krahاسimi i të dhënave me skedarë të tjerë që disponon INSTAT. 2. Trajtimi i mos-përgjigjeve Konsiderohen si mos-përgjigje të gjitha rastet: • Pa kontakt; • Refuzim i plotë; • Refuzime të pjesshme (për variabla apo tregues të veçantë). 3. Një peshë e përshtatshme llogaritet për secilën njësi që raportoi të dhënat e saj. • Kjo peshë llogaritet për arsye të ndryshme: probabiliteti i pabarabartë i përzgjedhjes, rregullimi i mos përgjigjes, NjEF që rezultojnë jashtë fushëveprimit, teknikat e kalibrimit.
--	--

18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
------------------	----------------

19. Komentë

Aneks

Më poshtë jepen vlerësimet për përdorimin e internetit deri në një vit më parë nga individët (16-74 vjeç) në total vendi dhe sipas gjinisë së bashku me devijimet standarde përkatëse.

Tabela 1. Treguesit e saktësisë së përdorimit të internetit deri në një vit më parë nga individët (16-74 vjeç) në nivel total vendi dhe sipas gjinisë.

Nivel Total Vendi	Vlerësimi i individëve	Devijimi Standart	Intervali i besimit (95%)	
			I poshtëm	I sipërm
Individë (16-74 vjeç)	89.4%	0.4%	88.6%	90.2%
Burra (16-74 vjeç)	90.2%	0.5%	89.2%	91.1%
Gra (16-74 vjeç)	88.6%	0.5%	87.6%	89.6%